



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 1196/2024
Datë: 25 nëntor 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nënparagrafi 1.32 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 4 paragrafit 2 të Rregullores Nr. 07/2024 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës dhe nenit 14 paragrafët 2 dhe 3 nënparagrafit 3.2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, në takimin e mbajtur me datë 25 nëntor 2024, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Lejohet monitorimi dhe qasja në shikim të dokumenteve që nga fillimi e deri në përfundim të procesit të emërimit të kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës sipas konkurseve të shpallura me vendimet KPK/Nr. 1048/2024 dhe KPK/Nr. 1049/2024 të datës 15 tetor 2024 për përfaqësuesit ndërkombëtar si dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.
2. Obligohet Sekretariati që këtë vendim ta publikojë në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës



T'i dërgohet:

- Panelit vlerësues për emërim të Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit;
- Panelit vlerësues për emërim të Kryeprokurorëve të prokurorive themelore në Pejë, Prizren, Gjiilan, Mitrovicë dhe Ferizaj;
- Sekretariatit të SKPK-së;
- Arkivit të KPK-së.